



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0452

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Grdinja-Mexhuani duke vendosur sipas ankesës së OE "EUROFAMIS" SH.A. kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndertimi i fushave të futbollit në Bardhosh, Bernice dhe Matiqan-RITENER” me numër të prokurimit 616-23-4404-5-2-1, iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK) më 17/08/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohetsi e pabazuar ankesa e "EUROFAMIS" SH.A.e parashtruar në OSHP me 03/07/2023 (Protokolli 2023/0452) kundër njoftimit për anulim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndertimi i fushave të futbollit në Bardhosh, Bernice dhe Matiqan-RITENER”, me numër të prokurimit 616-23-4404-5-2-1, iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e AK , ndërsa vendimi i AK i datës 19.06.2023 për anulim, **Vërtetohet**.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 08.05.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka paraqitur Njoftimin për kontratë-B05, për aktivitetin e prokurimit me titull “Ndertimi i fushave të futbollit në Bardhosh, Bernice dhe Matiqan-RITENER” me numër të prokurimit 616-23-4404-5-2-1.

Me 12.05.2023, OE “EUROFAMIS” SH.A., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK - Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Kurse me datë 18.05.2023 AK, e kishte miratuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim duke korrigjuar njoftimin dhe ka bërë zgjatjen e afatit për

dorëzimin e ofertave të paktën prej 10 ditëve nga data e këtij vendimi.

Me 19.06.2023, AK ka publikuar B58-Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka anuluar aktivitetin e prokurimit në tërësi për arsye se asnjëri nga ofertuesit nuk janë të përgjegjshëm.

Me 19.06.2023, OE “EUROFAMIS” SH.A., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK e cila ishte refuzuar si e pabazuar nga AK me 23.06.2023.

Operatori ekonomik ankues i pakënaqur me Vendimin e AK-së, me 03.07.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër protokollit 452/23.

Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak,

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotësonte kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Paneli Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Lidhur me këtë, me 10.07.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

-Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar kurse vendimi i AK të mbetet në fuqi.

Konstatohet në vijim, se raporti i cituar si më sipër është pranuar nga të gjitha palët, me ç ‘rast AK është pajtuar me rekomandimin e ekspertit, ndërsa OE ankues nuk është pajtuar me rekomandimin e ekspertit.

Ankuesi “EuroFamis” SHA ka pohuar shkurtimisht si vijon “*me datë 19.06.2023, AK ka ANULUR aktivitetin të prokurimit dhe ne jemi OE i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Por në arsyetimin e AK thuhet se ne kemi tejkalluar buxhetin për këtë projekt. Siç edhe mundë ta shihni, Operator Ekonomik të përgjegjshëm janë dy operator dhe njëri operator ka vlerën e ofertës 182,296.70 Euro, ndërsa oferta e jonë është e përgjegjshme dhe ka çmimin prej: 179,048.88 Euro. Pra AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së në arsyetimin e eliminimit tonë si OE ofertues. Po ashtu ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së, sepse nuk na ka trajtuar si OE të barabartë. Në disa aktivitete të prokurimit AK përkundër që pranon oferta mbi buxhetin e*

planifikuar (gabimisht të ulët), i shpërblen me kontratë duke e rritur buxhetin, ndërsa në rastin tonë e ka refuzuar ofertën edhe pse e ka vlerësuar si të përgjegjshme dhe përkundër që ne e kemi paralajmëruar se vlera e parashikuar është dukshëm më e vogël se sa çmimet e tregut. Kërkojmë nga AK që të pranojë kërkesën tonë për rishqyrtim dhe të kthejë lëndën në RIVLERËSIM duke e rritur buxhetin konform çmimeve të tregut dhe të na shpall fitues si OE i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. AK Nuk ka marr parasysh LIGJIN PER BUXHET te miratuar nga Kuvendi i Kosovës për këtë projekt. Për këtë projekt: Ne vitin 2023 janë 100000 euro GQ dhe 100000 THV, Ne vitin 2024 janë: 100000 euro GQ dhe 100000 THV, Ne vitin 2025 janë: 100000 euro GQ dhe 100000 THV (GQ: Grant Qeveritar THV: Te Hyra Vetanake) Pra Komuna me qëllim e ka anuluar këtë procedure duke u arsyetuar se nuk ka buxhet ndërsa buxheti për këtë projekt konform Ligjit për Buxhet është i mjaftueshëm. Andaj ne KERKOJME nga OSHP që te detyron AK lenden ta ktheje ne RIVLERESIM dhe te na shpall fitues si Oe i përgjegjshme me çmimin më te ulet.”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, Paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, parashtruesat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe të Autoritetit Kontraktues.

Paneli vëren se Ankuesi ka pphuar/pretenduar se AK lidhur me këtë aktivitet ka shkelur nenin 1, 8, 9 dhe 59 dhe 62 të LPP-së dhe njëherësh ka propozuar që lënda të kthehet në rivlerësim dhe të shpallen si OE të përgjegjshëm me çmimin më të ultë.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të ekspertizës ka konstatuar se: AK me 19.06.2023 përmes Njoftimit mbi Vendimin e AK-së dhe Letrës Standarde, ka njoftuar OE-të pjesëmarrës për rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe arsyet e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit. Gjithashtu në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 23.06.2023 ndaj ankuesit, AK ka potencuar se "Autoriteti Kontraktues e pamundur të tejkaloj vlerën e parashikuar për kontratë në mungesë të mjeteve buxhetore shtese të planifikuara. Vlera e parashikuar për këtë kontratë ka qenë 150,000,00 euro, ndërsa parashtruesi ka dorëzuar ofertën me çmimin 179,048.88 euro respektivisht ka tejkaluar buxhetin e parashikuar për 29,048.88 euro". Andaj, lidhur me arsyet cekura më lartë, Eksperti shqyrtues konsideron se, sipas arsyetimit të dhënë nga Autoriteti Kontraktues, një situatë e tillë lidhur me Anulimin e aktivitetit

të prokurimit parashihet me paragrafin 2, nën paragrafin 2.1 të nenit 62 të LPP-së. paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 i nenit 62 të LPP-se “Përfundimi i Aktivitetit të prokurimit” përcakton si në vijim : “2. *Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njëërën nga arsyet: 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit*”. Po ashtu, lidhur me **Ndërprerjen e procedurave të prokurimit**, neni 43.7 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton: *43.7 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.* Bazuar në dispozitat e lartë cituara, aktiviteti i prokurimit përfundon pa dhënien e kontratës vetëm për njëërën nga arsyet e përcaktuara me nenin 62 të LPP-së, si dhe me dispozitat e përcaktuara me nenin 43 të RRPP-së. Vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit ka qenë: 150,000,00 €, Ndërsa, Vlera e ofertës të OE ankues, sipas Procesverbalit të hapjes së Tenderëve është: 179,048.88 €. Tutje sipas paragrafit 5 të nenit 8 të Rregullores për Prokurimin Publik, përcaktohet se: *"Personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDP janë të obliguar që para publikimit të Formularit B58 "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", të ri konfirmojnë që informatat financiare (DNPDP) nuk kanë ndryshuar"*.

Andaj, bazuar në dispozitat e ligjit dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik, gjithashtu duke u bazuar në sqarimet e lartë cituara, eksperti shqyrtues ka konsideruar se, Vendimi për Anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit nga AK është i bazuar. Autoriteti Kontraktues gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit gjithmonë duhet ta ketë parasysh qëllimin e këtij ligji të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1 të LPP-së:

Eksperti Shqyrtues konstaton se, duke i marrë parasysh faktet dhe argumentet e lartë cekura, OE ankues “EUROFAMIS” SH.A, mund të konsiderohet si palë pa interes juridiko material sipas nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së, për faktin se, edhe nëse lënda kthehet në ri vlerësim, AK sipas paragrafit 2 nën paragrafi 2.1 të nenit 62 të LPP-së si dhe paragrafit 7 të nenit 43 të RRPP-së, mund ta anulon këtë aktivitet të prokurimit mbi bazën se, oferta e OE ankues tejkalon vlerën e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues i ka analizuar shkresat e kësaj lënde si dhe faktet dhe rrethanat e cituara si më sipër dhe veprimet e ndërmarra nga të dyja palët (OE dhe AK), duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues ka konstatuar:

OE “Famis SHA” ka parashtruar ankese, duke pohuar se AK nuk ka bërë vlerësim konform neni 59 të LPP. Eksperti shqyrtues ka shpjeguar se ankuesi në fakt e ka tejkaluar vlerën e parashikuar të kontratës, ngase vlera totale e ofertës së ankuesit është 179,048.88 €, ndërsa vlera e parashikuar për këtë kontratë është 150,000,00 €. Në kontekstin e shkresave të kësaj lënde dhe

pretendimeve ankimore në rastin konkret Paneli mbështet të gjeturat dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues dhe të njëjtat i veçoi për faktin parimor se (si në shpjegimet e mësipërme lidhur me ankuesin “Famis SHA”) vlera e parashikuar përbën nocion kyç në kuptim të nenit 9, të LPP, dhe e njëjta përfshihet në çdo tip të kontratës, parashikuar me dispozitat e neneve 15, 16, 17, 18, 19, 20 të LPP dhe rrjedhimisht si e tillë përbën një nga kriteret fundamental për AK me rastin e zbatimit të përgjegjësiive sikurse kërkohen ato në kuptim të nenit 59 lidhur me nenin 60 të LPP.

Për këtë arsye, Paneli mbështet konstatimet e ekspertit shqyrtues edhe lidhur me analizat e tij përkitazi me pretendimet tjera të ankuesit në këtë rast, pa nevojë që ato të përfshihen, përshkruhen dhe/ose komentohen sërish në këtë vendim, përderisa ato kanë karakter i-relevant në raport me tejkalimin e vlerës së parashikuar. Në fakt, AK është i obliguar ta zbatoj po ashtu nenin 62, të LPP sipas të cilit, cituar: “Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit”.

-Përfundim –

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Po ashtu duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për panelin shqyrtues dhe çdo raport i tillë vlerësohet dhe analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, pohimeve të palëve, akteve dhe veprimeve të tyre, natyrisht duke e pasur parasysh edhe natyrën e shkeljeve eventuale në raport me qëllimin dhe rrjedhën e një aktiviteti të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli Shqyrtues e mbështet ndonjë raport apo ndonjë rekomandim të ekspertizës, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të panelit ashtu siç i adresohen kompetencat e tilla sipas nenit 105 të LPP.

Prandaj nisur nga të lartëcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konform nenit 1,6,7,62 pragrafi 2 pika2.1 dhe 117 të LPP-së lidhur me nenin 43.7 të Rregullorës për Prokurim Publik, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi kurse sipas pikës 2 të këtij vendimi vendosi në kuptim të nenit 118 lidhur me nenin 31 paragrafi 5 i Rregullorës së Punës së OSHP-së.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së parë, departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - EUROFAMIS SH.A.**
- Arkivës së OSHP-së: